

Nr. 8 prot.

Tiranë, më 15/07/2020

VENDIM

Nr. 8, datë 15/07/2020


“MBI

**MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (STAF AKADEMIK DHE STUDENT),
PËR ZGJEDHJET E AUTORITETEVE DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Senatit Akademik nr. 19, datë 10.02.2020 Mbi miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve"; si dhe të Urdhrave të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, dt. 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" (i ndryshuar), me nr. 108, datë 08.05.2020 "Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga pandemia e COVID-19" dhe me nr. 175, datë 30.06.2020 "Zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL-të Publike në Republikën e Shqipërisë"; Shkresës të Fakultetit të Artit Skenik me nr. 102 prot., datë 14.07.2020 dhe shkresës së Komisionit Zgjedhor Fakultetit të Artit Skenik me nr. 2/2 prot., datë 15.07.2020; Shkresës të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 40 prot., datë 14.07.2020 dhe shkresës së Komisionit Zgjedhor Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 6 prot., datë 15.07.2020 si dhe shkresës të Fakultetit të Muzikës me nr. 169/1 prot., datë 14.07.2020 dhe shkresës së Komisionit Zgjedhor Fakultetit të Muzikës me nr. 3 prot., datë 15.07.2020, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 15.07.2020, pasi diskutoi me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare (staf akademik dhe studentë), si trupë zgjedhore në Fakultetin e Artit Skenik, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e listës përfundimtare (staf akademik dhe studentë), si trupë zgjedhore në Fakultetin e Arteve të Bukura, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

3. Miratimin e listës përfundimtare (staf akademik dhe studentë), si trupë zgjedhore në Fakultetin e Muzikës, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim të dërgohet pranë Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve të Universitetit të Arteve.
5. Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve Universitetit të Arteve, kanë për detyrë afishimin e listave përfundimtare (staf akademik dhe studentë), nëpër ambientet e secilit Fakultet.
6. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ergys Krisiko

Anëtar

Orges Malaj

Anëtar

Ted Kamberi

Anëtar

Albjon Begaj

Anëtar

Suela Agolli

Kryetar

Sekretar: Armira Kapxhiu

